



**VENDIM**

**Nr. 143 Datë 07.12.2011**

**PËR  
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË CEZ SHPERNDARJE SH.A PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PERIUDHËN E TRETË  
RREGULLATORE 2012-2014**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga te Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë CEZ Shpërndarje sh.a dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës, mbi aplikimin për miratimin e Planit të Investimeve të CEZ Shpërndarje sh.a për periudhën e tretë Rregullatore 2012-2014.

**Konstatoi se:**

Aplikimi i CEZ Shpërndarje sh.a për planin e investimeve për periudhën e tretë Rregullatore 2012-2014 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të Rregullores për Proçedurat e Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve nga të Liçensuarit në Sektorin e Energjisë Elektrike.

Për gjithë sa më sipër në kushtet kur është përcaktuar detyrimi i uljes se nivelit të humbjeve teknike e jo teknike gjate periudhës së tretë rregullatore dhe është miratuar studimi përkatës i cili shprehet mbi shpërndarjen e nevojave për investime në arritjen e targeteve të vendosura, Bordi i Komisionerëve,

**Vendosi:**

1. Të miratoje, me kushtin e pikës 2 më poshtë, vlerat e investimeve të parashikuara ne aplikimin e bërë nga CEZ-Shpërndarje, për çdo vit dhe të ndara sipas grupimeve sipas tabelës bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Plani i investimeve miratohet me kushtin që investimet e zërave N/Stacione dhe Matje të rishikohen dhe plotësohen nga CEZ Shpërndarje deri në 31 Mars 2012 në frymën e observacioneve të bëra prezent nga ERE për dhënie prioritet investimeve me efektin më të shpejtë dhe me të lartë në zvogëlimin e humbjeve teknike e jo-teknike (linjat ABC, etj). Plani i rishikuar i Investimeve do të shqyrtohet dhe miratohet nga ERE deri më 15 Maj 2012.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e CEZ Shpërndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

### **Plani Investimeve te CEZ Shperndarje per periudhen 2012 - 2014**

	Plani Investimeve 2012	Plani Investimeve 2013	Plani Investim. 2014
<b>Totali:</b>	<b>6,500,473,553</b>	<b>6,692,500,000</b>	<b>7,003,410,000</b>

Pershkrimi	Plani Investimeve 2012	Plani Investimeve 2013	Plani Investimeve 2014
<b>1. Pajisje 110 kV</b>	<b>1,194,696,000</b>	<b>950,000,000</b>	<b>1,240,000,000</b>
1.1.Nenstacione	988,440,000	950,000,000	1,240,000,000
1.5. Project preparation 110kV	20,000,000		
2.3. Transformatore fuqie TL/TM	186,256,000		
<b>2. Pajisje 6kV-35kV</b>	<b>1,937,251,020</b>	<b>1,560,000,000</b>	<b>1,767,410,000</b>
2.1. Linja 6kV - 35kV	1,766,549,008	1,560,000,000	1,767,410,000
2.3. Transformatore fuqie TM/TM	24,430,000		
2.4. Matesa TM	17,220,000		
2.5. Lidhje te reja TM	50,000,000		
2.9. Kabina transformacioni TMTU	79,052,012		
<b>3. Pajisje të Tensionit të Ulët</b>	<b>3,022,066,133</b>	<b>3,973,000,000</b>	<b>3,770,000,000</b>
3.1. Linja TU	1,377,038,038	2,453,000,000	2,310,000,000
3.3. Transformatore fuqie TM/TU	100,000,000	100,000,000	100,000,000
3.4. Matesa TU	1,545,028,095	1,420,000,000	1,360,000,000
<b>4. Investime të tjera mbështetëse</b>	<b>346,460,400</b>	<b>209,500,000</b>	<b>226,000,000</b>
4.1. Sistemi SCADA			35,000,000
4.2. Prona , ndertesa , orendi	172,940,000	50,000,000	102,000,000
4.3. Studime dhe Konsulenca	15,620,400	15,000,000	15,000,000
4.4. Hardware&Software	115,500,000	80,500,000	
4.5. Teknologji WAN	42,400,000	64,000,000	74,000,000
<b>Totali:</b>	<b>6,500,473,553</b>	<b>6,692,500,000</b>	<b>7,003,410,000</b>

**KRYETARI**  
**Sokol RAMADANI**